



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 32, datë 14.02.2019

MBI

PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË KRYEINSPEKTORIT TË ISH KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR ARKIVIMIN E ANKESËS OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 14.02.2019, bazuar në nenin 62, pika 13 dhe 14 e ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në vendimin nr. 31 datë 14.02.2019 “Mbi ngritjen e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish këshillit të lartë të drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”, si dhe të shortit të realizuar për këtë qëllim,

V E N D O S I:

1. Komisioni i Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, përbëhet nga:
 - Z. Alban Toro – anëtar,
 - Znj. Fatmira Luli – anëtare,
 - Z. Dritan Hallunaj – anëtar.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR